

VENDIM
Nr. 182, datë 7.8.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “AMEL ENERGY” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET PRODHUES 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2174/1 prot., datë 1.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Amel Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Amel Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2174 prot., datë 28.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën e kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaroi se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, se angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 2428 rep., nr. 1573 kol., datë 28.4.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Amel Energy” sh.p.k.”.

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a., me nr. 5721/3 prot., datë 28.6.2022.

- Shoqëria është pajisur me VNM paraprake, lëshuar më 2.5.2024 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtim impianti gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, dhe veprave ndihmëse”.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

- Shoqëria duhet të depozitojë në format origjinal kontratën për ndërtimin e centralit dhe të japë sqarime mbi stafin teknik që do të angazhohet me operimin e centralit dhe ta pasqyrojë këtë në organigramën e saj (**germa “c”**).

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

Shoqëria duhet të depozitojë:

- Vërtetim të përditësuar që provon se nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (germa “a”).

- Sqarimet përkatëse në rast të ndryshimit të mënyrës së financimit dhe dokumentacion vërtetues për disponimin e vlerës së mbetur të nevojshme për financimin e projektit (germa “b”).

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

2.1: Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- Raportimet periodike drejtuar MIE-s, në përputhje me afatet e marrjes së lejeve për ndërtimin e centralit dhe të vlefshmërisë së VNM-së (e vlefshme deri më 2.5.2026), si dhe informacion dhe/ose dokumentacion mbi fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaike (germa “c”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Amel Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Amel Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti